

# Ndjekja: Çfarë të prisni

## Çfarë është ndjekja?

- + Ndjekja, gjithashtu e quajtur ndjekja e kontaktit, përfshin gjetjen e personave të diagnostikuar me ose të ekspozuar ndaj COVID-19 të cilëve u kërkohet që të qëndrojnë larg njerëzve të tjerë derisa të mos mund ta përhapin më virusin.
- + Ndjekja është një pjesë kritike e planit të Qytetit të Nju Jorkut për të frenuar shpërthimin e COVID-19 dhe për ta hapur qytetin në mënyrë të sigurt.

## Cilët janë Ndjekësit e Kontaktit?

- + Ndjekësit e Kontaktit janë pjesë e Test & Trace Corps (Skuadrat e testimi dhe ndjekjes). Ata marrin në telefon personat e diagnostikuar me COVID-19 dhe ju kërkohen atyre të qëndrojnë larg nga njerëzit e tjerë.
- + Ndjekësit e Kontaktit më pas zbulojnë se kush tjetër mund të ketë qenë i ekspozuar ndaj COVID-19 dhe ju kërkohen atyre që edhe ata të qëndrojnë larg nga njerëzit e tjerë.

## Pse po më telefonon një Ndjekës i Kontaktit?

- + Ndjekësit e Kontaktit u telefonojnë personave të diagnostikuar me ose të ekspozuar ndaj COVID-19.
- + Ndjekësi juaj i Kontaktit:
  - Do t'ju pyesë se si po ndiheni.
  - Do t'ju pyesë nëse keni nevojë për burime që t'ju ndihmojnë të qëndroni i shëndetshëm dhe të mënjaroni përhapjen e COVID-19.
  - Do t'ju shpjegojë se për sa kohë do t'ju duhet të rrini brenda dhe larg nga njerëzit e tjerë.
- + **Nëse u diagnostikuar me COVID-19**, Ndjekësi juaj i Kontaktit gjithashtu:
  - Do t'ju bëjë pyetje që të zbulojë se si mund të jeni infektuar.
  - Do t'ju kërkojë emrat dhe informacionin e kontaktit të të gjithë personave me të cilët patët kontakt të afërt ndërsa kishit mundësi për ta përhapur virusin te të tjerët.
- + Nëse Ndjekësi juaj i Kontaktit nuk mund t'ju kontaktojë me anë të telefonit, ai mund t'ju vizitojë personalisht që t'ju kontrollojë.

## Çfarë është "kontakti i afërt" me dikë të diagnostikuar me COVID-19?

- + Personat që kanë patur "kontakt të afërt" përfshijnë ata që:
  - Jetojnë me dikë të diagnostikuar me COVID-19.
  - Puthën apo patën marrëdhënie seksuale me dikë të diagnostikuar me COVID-19.
  - Ofruan kujdes në shtëpinë e dikujt të diagnostikuar me COVID-19.
  - Ishin për 10 minuta ose më shumë brenda 6 feet me dikë të diagnostikuar me COVID-19.
- + **Nëse u diagnostikuar me COVID-19**, Ndjekësi juaj i Kontaktit do t'ju ndihmojë që të zbuloni se cilët janë kontaktet tuaja të afërta.

## Si e di unë nëse personi që më merr në telefon është nga Test & Trace Corps (Skuadrat e testimiit dhe ndjekjes)?

- + Ndjekësi juaj i Kontaktit do t'ju telefonojë nga një numër që thotë "NYC Test + Trace."
- + Ndjekësi juaj i Kontaktit ASNJËHERË nuk do t'ju kërkojë numrin tuaj të sigurimit social, numrin e kartës së kreditit ose informacionin e bankës. Nëse dikush ju merr në telefon duke ju kërkuar këtë informacion dhe thotë se është nga Test & Trace Corps (Skuadrat e testimiit dhe ndjekjes), mbylleni telefonin.
  - Ndjekësi juaj i Kontaktit mund t'ju kërkojë të identifikoni informacion të tillë si data e lindjes dhe adresa.

## Si e morën informacionin tim Test & Trace Corps (Skuadrat e testimiit dhe ndjekjes)?

- + **Nëse u diagnostikuar me COVID-19**, Test & Trace Corps (Skuadrat e testimiit dhe ndjekjes) e morën informacionit tuaj nga Departamenti Shëndetësor i Qytetit të Nju Jorkut.
  - Ligji i Shtetit të Nju Jorkut dhe Kodi Shëndetësor i Qytetit të Nju Jorkut ju kërkon laboratoreve të dërgojnë informacionin te Departamenti Shëndetësor i Qytetit të Nju Jorkut në lidhje me rezultatet e testit të COVID-19.
  - Departamenti Shëndetësor i Qytetit të Nju Jorkut ndau në mënyrë të sigurt informacionin me Test & Trace Corps (Skuadrat e testimiit dhe ndjekjes) në përputhje me ligjet e privatësisë që e lejojnë këtë lloj informacioni që të përdoret për të mbrojtur shëndetin e publikut dhe ndalimin e përhapjes së sëmundjes.
- + **Nëse keni qenë i ekspozuar ndaj COVID-19**, Test & Trace Corps (Skuadrat e testimiit dhe ndjekjes) e morën informacionin tuaj sepse dikush i diagnostikuar me COVID-19 i tha një Ndjekësi të Kontaktit se keni qenë në kontakt të afërt me të ndërsa ai mund të ishte duke shpërndarë virusin.
  - Ndjekësi juaj i Kontaktit nuk mund t'ju thotë se kush ju tha atyre se ju ishit në kontakt të afërt. Të gjitha informacionet personale të ndara me Test & Trace Corps (Skuadrat e testimiit dhe ndjekjes) do të mbahen konfidenciale siç kërkohet nga ligji.

## Sa shpesh do të më telefonojë Ndjekësi i Kontaktit?

- + Ndjekësi juaj i kontaktit do t'ju telefonojë çdo ditë për afërsisht 10 ditë - ndonjëherë më pak ose ndonjëherë më shumë - për të parë se si jeni.
- + Bëni çdo përpjekje të mundshme për t'ju përgjigjur telefonit kur Ndjekësi i Kontaktit ju telefonon. Identifikuesi i telefonit do të thotë "NYC Test + Trace."
- + Nëse Ndjekësi juaj i Kontaktit nuk mund t'ju kontaktojë, ata mund t'ju vizitojnë personalisht që t'ju kontrollojnë.

## Si do ta sigurojnë konfidencialitetin tim Test & Trace Corps (Skuadrat e testimiit dhe ndjekjes)?

- + Informacioni personal që ju ofroni do të përdoret vetëm nga Test & Trace Corps (Skuadrat e testimiit dhe ndjekjes) për qëllime të mbrojtjes së shëndetit publik dhe t'ju ofrojë burime për të cilat keni nevojë ndërsa qëndroni të ndarë nga njerëzit e tjerë. Informacioni do të mbahet në mënyrë të sigurt.
- + Test & Trace Corps (Skuadrat e testimiit dhe ndjekjes) do të mbrojnë konfidencialitetin e informacionit tuaj siç kërkohet nga ligji.

## Pse Ndjekësit e Kontaktit duhet të marrin në telefon personat për të cilët dihet se janë të ekspozuar ndaj COVID-19?

- + Personat e diagnostikuar me COVID-19 mund t'i lajmërojnë vetë kontaktet e tyre të afërta në lidhje me ekspozimin e tyre, por është e rëndësishme që një Ndjekës i Kontaktit gjithashtu t'ju telefonojë këtyre kontakteve të afërta për t'i ndihmuar ata që të testohen, të monitorohen simptomat e tyre dhe t'ju ofrohen atyre shërbime për të cilat mund të kenë nevojë.

## Ndjekësi im i Kontaktit a do ta ndajë informacionin tim me zbatuesit e ligjit ose shërbimet e imigracionit?

- + Çdo informacion që ndani me Ndjekësin tuaj të Kontaktit nuk do të ndahet me imigracionin, zbatuesit e ligjit ose zyrtarët e drejtësisë përveçse si kërkohet nga ligji.

## **A më lejohet që të dal jashtë nëse Ndjekësi im i Kontaktit më thotë se jam diagnostikuar me ose ekspozuar ndaj COVID-19?**

- + Nuk duhet të dilni jashtë derisa Ndjekësi juaj i Kontaktit t'ju thotë se është NË RREGULL që ta bëni një gjë të tillë, përveçse kur keni nevojë për kujdes thelbësor mjekësor (për shembull, për një sesion të dializës ose urgjencë mjekësore).
  - Përgjigjuni telefonatës së Ndjekësit tuaj të Kontaktit çdo ditë kështu që ata të mund t'ju thonë se kur mund të dilni përsëri nga shtëpia juaj.
  - Nëse keni nevojë të dilni jashtë për të marrë kujdesin mjekësor, vishni një mbulesë të fytyrës dhe lajmëroni ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor para kohe se jeni diagnostikuar me ose ekspozuar ndaj COVID-19.
- + Nëse nuk mund të qëndroni në mënyrë të sigurt larg nga personat e tjerë në shtëpinë tuaj, njoftoni Ndjekësin tuaj të Kontaktit ose telefononi 844-NYC-4NYC (844-692-4692). Ata mund të ndihmojnë në zënien a një dhomë hoteli falas për ju.

## **A do t'i ndjekin lëvizjet e mia Test & Trace Corps (Skuadrat e testimit dhe ndjekjes)?**

- + Jo. Test & Trace Corps (Skuadra e testimit dhe ndjekjes) nuk përdorin teknologji smartfon ose ndonjë qasje tjetër për të ndjekur lëvizjet tuaja.
- + Nëse një Ndjekës i Kontaktit vjen për t'ju vizituar personalisht, është që t'ju kontrollojë ju dhe shëndetin tuaj dhe të mësojë se kush tjetër mund të jetë ekspozuar ndaj COVID-19.

## **A do të arrestohem ose gjobitem nëse dal jashtë?**

- + Jo, ju nuk do të arrestoheni ose gjobiteni nëse dilni jashtë.
- + Për të parandaluar përhapjen e COVID-19, është shumë e rëndësishme që ju të qëndroni brenda dhe larg nga personat e tjerë në familjen tuaj derisa Ndjekësi juaj i Kontaktit t'ju thotë ndryshe, përveçse kur keni një urgjencë mjekësore.
  - Ju mund të njoftoni Ndjekësin tuaj të Kontaktit në lidhje me çdo send të nevojshëm për të cilin keni nevojë gjatë kontrollit tuaj ditor me të. Ata do të sigurojnë që t'ju sillen në vend ushqim, ilaçe dhe ndihmë tjetër që ju nevojitet kështu që të mos dilni jashtë.

## **A do të konsiderohem një "ngarkesë publike" sipas ligjit të imigracionit sepse fola me Ndjekësin tim të Kontaktit?**

- + Jo. Bashkëbisedimi me Ndjekësin tuaj të Kontaktit nuk do të ndikojë në mundësinë tuaj për të aplikuar për një kartë jeshile.
- + Trajtimi mjekësor ose shërbimet parandaluese të kujdesit shëndetësor të lidhura me COVID-19 NUK do të konsiderohen nën rregullin e ngarkesës publik.

## **A mund të marr leje shëndetësore të paguar nëse nuk mund të shkoj në punë?**

- + Ju mund të keni të drejtë për leje shëndetësore të paguar ose leje të zgjatur të familjes sipas Aktit federal të Përgjigjes ndaj Koronavirusit Familjet të Parat apo sipas Ligjit të Lejes Shëndetësore me Pagesë të Shtetit të Nju Jorkut të miratuar në përgjigje të pandemisë COVID-19.
- + Vizitoni [Leja me Pagesë e Re për COVID-19](#) ose telefononi 311 për informacion të mëtejshëm.

**Për informacion të mëtejshëm, vizitoni [TestandTrace.NYC](#) ose telefononi 311**